



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:233275

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05734698

KE.nr.170/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike të paditësve 1.N.SH Agjencioni Turistik “Air Munich” me numër të biznesit 70664755 me seli në Mitrovicë të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Alban Arifi nga Prishtina, 2.Reisburo Prishtina me numër unik identifikues 810005901, me adresë rr. “Nëna Terezë” nr.25/A, 3.Sky Express SH.P.K., me numër të biznesit 70772035 me adresë rr.”Bill Clinton” p.n, në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Alban Arifi nga Prishtina, kundër të paditurve 1. Gazeta ditore “Zëri “ me seli në Prishtinë rr.”Ish Rilindja”, 2.E.V., me vendbanim në fshatin Bërnice, Komuna e Prishtinës, me objekt kontesti kompensimin e dëmit nga shpifja dhe fyerja, jashtë seancës me datën 24.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komeriale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet JO KOMPETENTE në pikëpamje lëndore, për të vendosur sipas padisë së paditësve 1.N.SH Agjencioni Turistik “Air Munich” , 2.Reisburo Prishtina, 3.Sky Express SH.P.K., me numër të lëndës KE.nr.170/22 (2019:233275) të datës 07.02.2018, kundër të paditurve 1. Gazeta ditore “Zëri “, 2. E.V., me objekt kontesti kompensim dëmi nga shpifja dhe fyerja.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda së bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm.

A r s y e t i m

Paditësit 1.N.SH Agjencioni Turistik “Air Munich” , 2.Reisburo Prishtina, 3.Sky Express SH.P.K., me datë 07.02.2018 kanë paraqitur padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, kundër të paditurve 1. Gazeta ditore “Zëri “, 2. E.V. me të cilën kanë kërkuar që të aprovohet si e bazuar kërkesëpapia e paditësve dhe të obligohen të paditurit që paditësve ti kompensojnë dëmin, në emër të dëmit jo material për shkak shpifjes dhe fyerjes.

Kjo lëndë, është transferuar në Gjykatën Komerciale sipas Vendimit nr.347/2022 të datës 28.07.2022 të KGJK-së për transferimin e lëndëve në Gjykatën Komerciale.

Gjykata gjatë shqyrtimit të padisë dhe shkresave të lëndës në përputhje me nenin 17 dhe 19 të LPK-së, vlerësoi kompetencën lëndore të Gjykatës në këtë çështje juridike dhe gjeti se Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje.

Gjykata duke u bazuar në nenin 13 par. 1.1 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, me të cilin përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”*, lidhur me paragrafin 2 i cili përcakton se: *“Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.9 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti për Çështje Ekonomike”*, vlerëson se çështjet që kanë të bëjnë me shpifje dhe fyerje, nuk bien në kompetencë të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Departamenti për Çështje Ekonomike, për shkak se shpifja dhe fyerja, nuk hyn në kuadër të çështjeve të ndërsjella tregtare dhe as çështjeve tjera që ndërlidhen me raportet afariste në mes tyre, ndërsa duke u bazuar në nenin 12 dhe 20 të Ligjit për Gjykata (Ligji nr. 06/L-054), kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 dhe 19 lidhur me nenin 387.1 pika (u) dhe nenin 392 pika. (b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.170/22, datë 24.05.2024

Gjyqtari
Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate